



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **64**

Prishtinë, më 11.4.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Mungoi : Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH (Vjosa Vela dhe Ferki Fejza), bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 2 dhe 5.4.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2 dhe 5.4.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2 dhe 5.4.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Rrezatime

Kryetari Nait Hasani në vazhdim konstatoi se Ministri i MMPH nuk është përgjigjur ftesës përkundër njoftimit të rregullt kur është njoftuar për pasojën e mosardhjes në mbledhjen e sotme, ngase i njëjti është dashur që sot pranë komisionit të propozoj mundësinë e zgjedhjes së çështjes së këtij projektligjit, a duhet të mbetet Agjencia pranë MMPH apo pranë Zyrës së Kryeministrit, ndaj Komisioni unanimisht nxori këtë :

REKOMANDIM

I rekomandohet mbledhjes plenare të mos miratohet në shqyrtim të dytë Projektligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

4. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme Kryetari **Nait Hasani** konstatoi se **Projektligji për Ndërtimin** ka ndikuar në ndryshimin e agjendës së shqyrtimit të projektligjeve në Komision, ndaj propozoi dëgjimin publik për ditën e martë më 17 prill 2012 në orën 10,00. Komisioni u pajtua dhe u sugjerua të ftohen të gjithë palët e interesuar : Komunat, shoqatat, ekspertët etj. Lidhur me caktimin e grupit punues, komisioni u pajtua që tërë komisioni të angazhohet në shqyrtimin e projektligjit në cilësinë e grupit punues.

Në vazhdim u sugjerua caktimi i GP për dy projektligjet për parqe (Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri), ndërkaq për shkak të mungesës së ofertave konkrete, kryetari propozoi që kjo çështje të kryhet në mbledhjen e radhës. **Afërdita Berisha** ripërsëriti kërkesën për z. Naim Ramadani ndërkaq **Sevdije Lama** për z. Arbnor Hoxha. **Arbnor Hoxha** dhe **Fatos Lajçi** më 27.12.2012 u propozuan nga Komisioni si ekspert profesional për këto dy projekte, ndërsa eksperti ligjor do të propozohet nga kryetari i komisionit. Për ekspertin e propozuar nga **Sevdije Lama** z. Arbnor Hoxha u pat kërkuar të prezantoi në mbledhjen e radhës për shkak të harmonizimit të disa fakteve të cekura në CV-në e tij personale. Për Projektligjin e Bujqësisë Organike Komisioni miratoi kërkesën për ekspertin **Zenel Bunjaku**, mirëpo për shkak të kompletimit të shënimeve, vendimet do të sjellën në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11,40

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani